



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2018:066917

Datë: 26.06.2019

Numri i dokumentit: 00371333

P.nr.821/18

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – Departamenti i përgjithshëm, gjyqtarja e vetme gjykuese Diana Sina, me procesmbajtësen Lamije Kuqi, – sekretare juridike pranë kësaj gjykate, në lëndën penale kundër të akuzuarit A. B. nga Gjakova, i akuzuar sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Gjakovë, me numër PP.nr.1649/2018, të datës 19.11.2018, për shkak të veprës penale mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, nga neni 374 par.1 të KPRK-së, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datën **18.06.2019**, në prezencën e Prokurorit të shtetit Anton Hasanaj, të akuzuarit, po të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datën **26.06.2019** përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari **A. B.**, i biri i N., i nënës L., e gjinisë G., i lindur me datën në Gjakovë, ku dhe tani banon në rrugën "D. e L.", nr. ..., ka të kryer shkollën e mesme, tani është student, muzikant, i pa martuar, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse: Më parë ka siguruar dhe gjer me datën 25.10.2018 rreth orës 22:00 min në Gjakovë, rr."D. e L.", pn, pa autorizim ka mbajtur arme e municion e në kundërshtim me nenin 4 prg.1 nën.prg.1.1 të Ligjit për Armë e R. Kosovës, të cilat me ligj kategorizohen si armë zjarri të ndalura e për të cilat kërkohet leja, dhe atë 1(një) Pistoletë, prodhimi "Zastava" CZ me nr.serik, me 1 (një) karikator të zbrazët dhe 57 fishek te cal.9 mm dhe 25 fishek të cal.7.65mm, ashtu që arma i është sekuestruar e gjenden në dhomën e dëshmive në Stacionin policor në Gjakovë.

-me çka ka kryer veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së.

Gjykata në bazë të nenit 4,17 par.1,41,46,73 dhe nenit 374 par.1 të KPRK-ës, si dhe nenit 365 të KPPK-ës, i shqipton;

DËNIM ME GJOBË:

Dënim me gjobë në shumë prej **1000 (Njëmijë)** Euro, të cilën shumë obligohet që ta paguaj në afat prej **15 ditësh**, pasi që Aktgjykimi të merre formë të prerë e nën kërcënim të përmbartimit me dhunë.

Nëse personi i dënuar nuk dëshiron ose nuk mund ta paguaj gjobën, Gjykata në bazë të nenit 46 par.3 të KPPK-ës, dënimi me gjobë do ta zëvendësoi me dënim burgu në kohëzgjatje prej **50 (pesëdhjetë) ditësh**, duke llogaritur çdo ditë të qëndrimit në burgim nga **20.00-€.(njëzet) euro**, të gjobës.

Detyrohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve procedurale, në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej **30,00.-Euro**, ndërsa për programin për kompensimin e viktimave të krimit **shumën prej 30.- euro**, e të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi

I SHQIPTOHET – dënimi plotësues, i konfiskohet 1(një) Pistoletë, prodhimi “Zastava” CZ me nr.serik 149693, me 1 (një) karikator të zbrazët dhe 57 fishek te cal.9 mm dhe 25 fishek të cal.7.65 mm., komfor nenit 374 par.3 të KPRK-ës.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë, pranë kësaj gjykate, ka parashtruar aktakuzën PP.nr.1649/2018, të datës 19.11.2018, kundër të akuzuarit A. B. nga Gjakova, për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së, duke propozuar gjykatës që i njëjti të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

I akuzuari A. B. në shqyrtimin fillestar lidhur me fajësinë, deklaroi se e pranon fajësinë për veprën penale me të cilën ngarkohem ashtu siç është përshkruar në dispozitiv të aktakuzës, për të cilën vepër jam penduar pa masë duke premtuar se në të ardhmen nuk do të përsërisë të njëjtën, armen e kam blerë në Prizren, por të njëjtën asnjëherë nuk e kam përdorur, dhe as që kam pasur qëllim, që të njëjtën t’ja përdori, shton se jam në gjendje të dobët materiale, merrem me muzikë herë pas here, për here të parë paraqitem në gjykatë për një vepër të kryer penale por premtoi se kjo do të jetë hera e fundit, andaj i propozoi gjykatës që të merr parasysh rrethanat e lartë përmendura me rastin e shqiptimit të llojit dhe lartësisë së dënimit.

Duke u deklaruar lidhur me mendimin lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, Prokurori i Shtetit nuk e kundërshton pranimin e fajësisë, pasi që i njëjti kupton natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimin e fajësisë e bënë me vullnet dhe vetëdije të plotës, si dhe pranimi i fajësisë mbështetet në provat dhe faktet që përmban aktakuza.

Në shqyrtimin fillestar gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Në tërësi u vërtetuar se i akuzuari A. B.: Më parë ka siguruar dhe gjer me datën 25.10.2018 rreth orës 22:00 min në Gjakovë, rr.”Dëshmoret e Lirisë”, pn, pa autorizim ka mbajtur arme e municion e në kundërshtim me nenin 4 prg.1 nën.prg.1.1 të Ligjit për Armë e R. Kosovës, të cilat me ligj kategorizohen si armë zjarri të ndalura e për të cilat kërkohet leja, dhe atë 1(një) Pistoletë, prodhimi “Zastava” CZ me nr.serik, me 1 (një) karikator të zbrazët dhe 57 fishek te cal.9 mm dhe 25 fishek të cal.7.65mm, ashtu që arma i është sekuestruar e gjenden në dhomën e dëshmimeve në Stacionin policor në Gjakovë.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga i akuzuari, i cili në shqyrtimin fillestar vullnetarisht ka pranuar fajësinë, për shkak të cilës gjykata nuk ka administruar provat, gjykata ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga i akuzuari është bërë në pajtim me nenin 248 të KPP-së. Gjatë pranimit të fajësisë gjyqtarja e vetme gjykues konstatoi se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjet që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga Prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Gjykata nga të cekurat më lartë ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e qenies së veprës penale të përshkruar si në shqiptim të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarin të shpall fajtor dhe të gjykojë në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 73 të KPRK-së të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarit: gjendjen e tij ekonomike, pranimin e fajësisë, pendimin e tij dhe premtimin se në të ardhmen nuk do të përsërisë veprën e tillë, sjelljet tejet korrekte gjatë gjykimit, sjelljet e tij para dhe pas kryerjes së veprës, më parë i pa dënuar ,si rrethana rënduese gjykata mur peshën e veprës penale, rrethanat në të cilat është kryer vepra, shkallën e përgjegjësisë penale, të gjitha këto rrethana ndikuan që Gjykata të akuzuarit ti shqiptoi dënim me gjobë në shumë prej 1000-Euro, me bindje se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me dispozitën e nenit 41 i KPRK-së dhe ky dënim i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale në emër të paushallit gjyqësor, është marr komfor nenit 450 par. 1 dhe 2 nën par. 2.6 lidhur me nenin 453 të KPPK-se, si dhe për shpenzimet për programin për kompensimin e viktimave të krimit duke u bazuar në nenin 39 par.3 nënpar.3.1 të Ligjit Nr.05/L-036.për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, konform nenit 365 të KPP-së.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË
- Departamenti i përgjithshëm -
P.nr.821/18 me datën 18.06.2019

Sekretarja juridike,
Lamije Kuqi

Gjyqtarja e vetme gjykuese,
Diana Sina

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh pas marrjes së aktgjykimit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate.

Numri i lëndës: 2018:066917
Datë: 26.06.2019
Numri i dokumentit: 00371333